

SHËRBESA E LANJËTORES SË SHENJË

Passi thuhet Urata Perpara Tribunes te Enjten e Madhe ne mengjës, Prifti, i veshur me robat e Meshes, del me Temjanicen dhe me llambadhe perpara portes se Kishes, ku eshte gatitur Lanjetorja prej Kryekishetarit, edhe jane radhitur te dymbedhjete Vellëzerit, te cilëve do tu lajne kembet Prellati. Midis te dymbedhjeteve duhet te jete doemós Portari dhe Kujdestari i Manastirit ose i Kishes. Gjer sa te dalin te gjithë, dhe te mblidhen ne hoborrin e Kishes, kendohet Psalmi 51:

PSALMI 51

Meshirome, o Perëndi meshireplót, edhe me shumicen e meshirave te tua shúaji paudhesít' e mia. Laj-me fare prej paudhesisë sime, dhe qerome prej mekatit tim. Se un' i njoh paudhesít' e mia, dhe mekatin tim e kam perpara syve kurdoherc. Kunder teje vetem fejeva, dhe perpara teje e bera te keqen, qe te dalesh i drejte ne fjalet e tua, dhe te jesh i kthjellët ne gjyqet e tu. Se ja tek u-zura ne paudhesí, dhe ne mekata me lindi nena ime. Se ja tek deshe te verteten ne zemër, dhe mendjes sime do ti tregósh urtesí. Sperkat-me me hysóp, dhe do te qerohem, laj-me, dhe do te behem mé i bardhe se debora. Bej-me te degjónj gezím e ngazellím, qe te me gezohen eshtrat e thýera. Ktheje faqen nga mekatat e mia, dhe shúaji gjithë paudhesít' e mia. Kthjelloma zemren, o Pe-

rendí, dhe perscritma frymen e drejte. Mos me hith tej prej faqes sate, dhe mos ma merr frymen tende te shenjte. Epma prape gezimin e shpetimit tent, edhe forcome me fryme zoterishte. Do tu mesónj fajtóreve udhet e tua, dhe te pabesët do te kthehen me ty. Shpetome prej gjakrash, o Perëndi, Perendia i shpetimit tim, gjuha ime do ta lavderonje me gezím drejtesine tende. O Zot, çelmi buzët, edhe goja ime do ta leçite lavdine tende. Se te dáshkeshe therore, do te kisha prurë, po hollokostet nuke te pelqejne. Therore e Perendise eshte frym' e thyer; zemren e thyer dhe te perunjur nuke do ta hedhesh tej, o Perëndi. Bej-i mire Sionës pas pelqimit tent; edhe ndertoji muret e Jerusalemit. Ahere do te pelqësh therore drejtesie, dhurata dhe hollokoste. Ahere do te bien dema mi Alltarin tent, edhe meshirome, o Perëndi.

Pastáj Dhjaku thote Litanine e Madhe:

DHJAKU: Me paqe le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per paqen qe lártazi dhe per shpetimin e shpírteve tona, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per paqen e tere botes, per mirevajtjen e Kísheve te shenjta te Perendise dhe per bashkimin e te gjithave, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Per Kryepeshkopin tone (*aqsh*), per prifterine dhe dhjakerín' e nderuar me Krish-

tin, për tërë klerin dhe pópullin, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Që të bekohet, e të shenjterohet kjo Lanjctore me fuqinë, veperimin dhe permindodhjen e Shpirtit Shenjt, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Që të çperlahen mekatat tona me anën e kësaj Sherbese, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Që të shpëtojme prej çdo hidherimi, mecie, reziku dhe nevoje, le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Perkraha, shpetona, meshirona dhe rúajna, o Perendí, me hirin tent.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Tereshenjten, të pacinúaren, të permibekúaren, të lavderúaren, Kryezonjen tonë, Hyjlíndesen dhe gjithënjé Virgjreshen Marí dyke kujtuar me gjithë Shenjtoret, veten tonë dhe njerjatrín dhe tërë jeten tonë Krishtit Perendí le tja pranojmë .

KORI: Ty, o Zot.

PRIFTI: Se ti je paqesimi i shpírteve tona, dhe ty të dergojmë lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín

Pastáj Prifti thote me ze të lartë keté Urate:

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

PRIFTI: O Zot, o Perendí zemermirë, që more

fytyrë robí dhe rrobe sherbëtori, dhe ua lave Dishépujve kembet me dúart' e tua të shenjta, dhe pastáj ua fshive me rizen; shtjer syrin edhe taní mi né, sherbëtoret e tu të pavyer, që po imitojmë shémbellen e lavderuar të perunjesisë sate; vleresona ti çperlajmë njollat e shpirtit e të trupit me prekjën e kësaj uje; dhurona permindodhjen e padukur të Shpirtit Shenjt; rúaji shpirtet edhe trupet tona nga gjárperi dinák, që na pergjón; paqesona që të të adhurojmë faqebardhë, dyke kapercyer gjërperinjte, agrepet edhe tërë fuqín' e armikut. Se ty të ka hie çdo lavdí, nder e adhurím, bashkë me Atin e panismë dhe me Shpirtin e tereshenjte dhe të mirë dhe jetëberës, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amín.

PRIFTI: Paqë të gjithëve.

KORI: Dhe me frymen tënde.

DHJAKU: Kreret túaja Zotit únjani.

KORI: Ty, o Zot.

DHJAKU: Le ti lútemi Zotit.

KORI: Meshiró, o Zot.

Pastáj Prifti thote me ze të unjur keté Urate:

PRIFTI: O Zot, o Perendia ynë, që na tregove masën e perunjesisë, dyke ngritur të funtmin si të parë; ti vleresona ti sherbejmë njerjatrít; lartësona me anën e perunjesisë; ruajna të paperlyer, të lartë me anën e lóteve, të paqesuar me hirin e dritës sate; që të gjejme meshirë, kur të pergjúj-

njemi përpara Tribunes sate se trémpshime.

Pastáj Prifti thote me ze te larte Thirrjen:

PRIFTI: Se ti je Perendí meshireplót e njeridashes, dhe ty te dergojme lavdí, Atit e Birit edhe Shpirtit Shenjt, taní e përherë dhe në jetet e jéteve.

KORI: Amin.

Pas Thirrjes, Prifti thote me ze te larte:

PRIFTI: Dhe që te vleresóhemi ta degjojme Ungjillin e Shenjte, Zotit Perendise tone le ti lútemi.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Urtésí, o te drejte. Le ta degjojme Ungjillin e Shenjte.

PRIFTI: Paqe te gjítheve.

KORI: Dhe me frymen tende.

PRIFTI: Kendimi prej Ungjillit te Shenjte pas Joanit.

DHJAKU: Le te veme re.

KORI: Lavdí me ty, o Zot, lavdí me ty.

Ne keté mes, te dymbedhjetet, te cíleve do tua lanje kembet Prellati, rrine mi fronet e pregatitur. Dhe kur nis Prifti te kendonje Ungjillin e pare, Prellati ben pikerisht ashtú, si thote Ungjilli. Dhe Ungjilli kendohet ngadale, i prere ne disa paragrafe, midis te cíleve ka pushime te gjata, qe ti jipet kohe Prellatit ti mbaronje hollesite e Sherbeses me nje menyre mé teper simbolike se literale. Pra, Ungjilli kendohet keshtú:

PRIFTI: M' até kohë, dyke ditur Jesúj, që Ati ia kishte dhënë te gjitha në dorë, dhe që kishte

ardhur nga Perendia, dhe do te kthehej me Perendinë, u-ngrit nga darka, dhe i çveshi robot;

Ketú Prellati e çvesh mantellen, dhe i pervësh menget.

PRIFTI: Edhe mori një peshqír, dhe e ngjeshi në mest.

Ketú Prellati merr një peshqír te math, edhe e ngjesh në mest.

PRIFTI: Pastáj hodhi ujë në Legjenin.

Ketú Prellati heth ujë në Legjenin.

PRIFTI: Edhe nisi tua lanje Dishépujve kembet, edhe tua fshinje me peshqirin, me te cilin ishte ngjeshur.

Ketú Prellati ua lan kembet te dymbedhjetëve, ua fshin me peshqirin, dhe ua puth me radhe, dyke nisur nga Portari dhe dyke mbaruar tek Kujdestari. Kur arrín tek Kujdestari, Prifti vazhdón pjesën tjetër te Ungjillit gjer në fund:

PRIFTI: Pastáj i vajti Simón Pjetrit, edhe ky i tha: “Zot, ti po mi lan kembet?” Jesúj u-pergjéq, edhe i tha: “Até që po benj unë, ti nuk e merr vesh taní, po do ta kupetósh pastáj.” Po Pjetri i tha: “Kurre nukë duhet te mi lash kembet.” Edhe Jesúj iu-pergjéq: “Në mos ti lafsha kembet, ahëre nukë ke asnjë lidhje me mua.” Edhe Simón Pjetri i tha: “Ahëre, o Zot, mi laj jo vetëm kembet, po edhe dúart’ edhe kokën.” Edhe Jesúj i tha: “I lari nukë ka nevojë veçse ti lanje kembet, edhe është i paqme i terti; edhe ju jini te paqme, po jo te gjithë.” Se e dinte se një prej atyre do ta tradhëton-

te; perandáj pra, tha: “Nuke jini te paqme te gjithë.”

KORI: Lavdí me ty, o Zot, lavdi me ty.

Passi mbarohet Ungjilli, Prellati e heq peshqirin, edhe e vesh mantellen. Pastáj Prifti thote Ungjillin e dyte:

PRIFTI: Dhe qe te vleresohemi ta degjojme Ungjillin e Shenjte, Zotit Perendise tone, le ti lútemi.

KORI: Meshiró, o Zot.

DHJAKU: Urtesí, o te drejte. Le ta degjojme Ungjillin e Shenjte.

PRIFTI: Paqe te gjithëve.

KORI: Dhe me frymen tende.

PRIFTI: Kendimi prej Ungjillit te Shenjte pas Joanit.

DHJAKU: Le te veme re.

KORI: Lavdí me ty, o Zot, lavdi me ty.

PRIFTI: M' até kohë, Jesús, passi u lau Dishë-pujve kembet, i veshi robot, u-shtrua ne sofer perserí, dhe u tha: “A e kupetuat seç' ju bera? Ju po me qúani Mesonjes edhe Zot; edhe keté e thoni mire, se ashtú jam. Pra, posa une, Zoti dhe Mesónjesi, jua lava kembet, edhe ju detyroni tua lani kembet njerjatrít. Se ju dhashe nje shembell, qe te beni edhe ju ashtú, sikunder ju kam bere une. Me te vertete, me te vertete po ju thom qe s' ka sherbetór mé te math se i zoti, as apostúll mé te math se aý, qe e ka derguar. Pra, taní, qe i dini ketó gjera, do te ijni te lumur, sikur ti beni.”

KORI: Lavdí me ty, o Zot, lavdí me ty.

Pas Ungjillit, qe te gjithë besniket i ngjýejne dúarte, dhe i kryqesojne fytyrat me ujen e Lanjetores. Pastáj qe te gjithë kthehen ne Kishe. Ne keté mes, kendohet Psalmi 145:

PSALMI 145.

Do te lartesonj, o Perendia im, o Mbreti im, edhe do ta bekónj emrin tent me jetet e jetes. Per dite do te bekónj, dhe do ta lavderónj emrin tent per jete dhe me jetet e jetes. Zoti esht i math e i lavderuar pa mase, dhe madheshtí' e tij nuke ka funt. Gjithë brezat, njéri pas tjatrit, do ti lavderojne veprat e tua, dhe do ta leçitin fuqine tende. Do te flasin per madheshtine, per lavdine dhe per shenjterine tende, dhe do ti tregojne çudirat e tua. Do ta çfaqin tmerrin e potérave te tua, do ti çpallin madheshtít' e tua. Do ta lavderojne shumicen e miresise sate, dhe do ta kendojne drejtesine tende me ngazellím. Zoti eshte hirplót e meshireplót, zemergjere dhe zemerdhempshur. Zoti esht i mire per te gjithë, dhe gjithë veprat e tij jane plot me dhempsherí. Dhe veprat e tua do te lavderojne, dhe Shenjtoret e tu do te bekojne. Do te flasin per lavdín' e Mbretetrisë sate, dhe do ta tregojne fuqine tende. Do tu bejne te njohur njéresve poteren tende dhe lavdín' e Mbretetrisë sate. Mbretëria jote eshte Mbretëri e perjétslime, dhe zoterimi yt ka per te vazhduar bres pas brezi. Zoti eshte besnik ne gjithë fjalet e tij, dhe i drejte ne gjithë veprat e tij. Zoti i perkráh atá, qe rezohen,

edhe i ngre atá qe jane krusur. Syt' e te gjithëve shpërejne prej teje, dhe ti u jep ushqimin e tyre ne kohen e duhur. Ti e hap doren, dhe e kenáq deshiren e gjithë gjërave te gjalla. Zoti esht i drejte ne gjithë sjelljet e tij, dhe i shenjte ne gjithë veptrat e tij. Zoti eshte gatí per gjith' atá, qe e thërresin, per gjith' atá, qe i luten me te vertete. Do tua mbaronje deshiren atyre, qe i kane frike; do tua degjonje klithmen, dhe do ti shpëtonje. Zoti do ti rúanje gjith' atá, qe e duan, dhe do ti shúanje gjithë te paudhet. Goja ime do ta çfaqë lavdín' e Zotit; çdo fryme le ta bekonje emrin e tij te shenjte per jete dhe me jetet e jetes.

Pastáj perndahet Nafora, dhe behet Perleshimi i Shkurter:

Krishti, Perendia yne i vertete, qe na dha shém-bellen e perunjesise, dyke lare kembet e Apostujve, me nermjetimet e Shen Marise dhe te gjithë Shenjtóreve, na meshirofte, dhe na shpëtofte si i mire dhe njeridashes.